

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 95, datë 17.06.2019 “Mbi miratimin “Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 12 korrik 2019 bëhet korrigjimi i gabimit material si më poshtë:

Dispozitivi i vendimit:

Ishte:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik” dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG.
2. Në rast mos – pajtueshmerie të kërkesave të kapacitetit me limitet e kapacitetit, Autoritetet do të njoftojnë me shkrim Palën e Interesuar. Në mungesë të këtij njoftimi, kërkesa konsiderohet e përmbushur.
3. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.

Bëhet:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik” dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG, në datë 14 June 2019 (Aneks B, i dakortësuar në vendimin e përbashkët në vijim Ankesi A, bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Në rast mospajtueshmërie të kërkesave të kapacitetit me limitet e kapacitetit, Autoritetet do të njoftojnë me shkrim Palën e Interesuar. Në mungesë të këtij njoftimi, kërkesa konsiderohet e përmbushur.
3. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
4. Aneksi A dhe B i këtij vendimi do të publikohen në faqen e internetit të ERE-s pas publikimit të tij në faqen e internetit nga Tap Ag.
5. Të përcjellë këtë vendim në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Autoritetin e Konkurrencës, në RAE, në AREG dhe shoqërinë TAP AG.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.